



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 27 prill 2017, në mbledhjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 10.00

Në mungesë të Kryetarit të komunës z. Agim Veliu, mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm: z. Bekim Bislimi, Komandant i Stacionit të Policisë; z. Radisav Perović, përfaqësues i Komunitetit serb; z. Shaban Ahmeti, kryesues i Komitetit për Komunitete; z. Avni Maloku, drejtor i Drejtorisë së Arsimit; z. Sami Ajeti, kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit në Nivel komunal; z. Naim Bajraktari, kapiten, përfaqësues i FSK-së; z. Rizah Muçolli, kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi, z. Faik Muçiqi, përfaqësues i Emergjencave Civile; z. Liman Zeqiri, përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim; z. Bunjamin Hoti, përfaqësues i OJQ-ve; z. Fadil Halimi, përfaqësues i Mediave lokale; dhe z. Idriz Hoxha, përfaqësues i komunitetit të personave me nevoja të veçanta.

Ndërsa munguan: z. Bekim Jashari, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islam; znj. Naime Podvorica, zyrtare për Barazi Gjinore dhe z. Avni Shabani, përfaqësues i Komunitetit të biznesit.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Përfaqësuesi i KFOR-it dhe z. Skender Shatri -OSBE.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, Mirë se keni ardhur, në emër të Kryetarit të Komunës i cili është i zënë me një punë në Qeveri e cila ka qenë e paplanifikuar, unë do të kryesoj mbledhjen e sotme. Ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrje. Rëndin e ditës me materialet besoj i keni marrë me kohë. Para se të fillojmë me punë desha të ndaj një moment të rëndësishëm, sot Gjykata e Colmarit në Francë ka vendos për lirim të z. Ramush Haradinaj, kryetarit të AAK-së, e ky është një lajmë i mirë për të gjithë shqiptarët dhe Kosovën në përgjithësi, edhe njëherë është vërtetuar se lufta e jonë ka qenë luftë e drejtë, ky është një moment i veçantë.

Të fillojmë me punë, nëse dikush ka diçka për të shtuar apo propozuar rreth rendit të ditës mund ta merrni fjalën.

1. Rend i propozuar i ditës

U miratua njëzëri

2. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 16 shkurt 2017

U miratua njëzëri

3. Raporte të Policisë së Kosovës dhe KFOR-it për gjendjen e sigurisë në Komunë

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, fjalën e ka Komandanti i Stacionit Policor z. Bekim Bislimi.

z. Bekim Bislimi, theksoi, gjendja e sigurisë në Komunën e Podujevës, vlerësohet e qetë, në bazë të informacioneve që kemi nuk pritet ndonjë eskalim në të ardhmen. Jemi të angazhuar në parandalimin e veprave penale të cilat cenojnë rendin dhe sigurinë në përgjithësi, përfshirë parandalimin e dëmtimit të pronës si dhe ngritjen e sigurisë në komunikacion. Brenda kësaj periudhe rezultatet janë evidente, muajt e kaluar bazuar në dyshet e bazuara dhe dëshmitë relevante kemi arrestuar 24 persona, të cilët kanë operuar në katër grupe në rajonin e qytetit të Podujevës, duke shkaktuar thyerjen e disa lokaleve dhe shtëpive.

Në lokacione të ndryshme por edhe në shtëpitë e të dyshuarve pas bastisjeve kemi hasur sendet e raportuara si të vjedhura, të cilat i kemi konfiskuar dhe iu kemi kthyer pronarëve. Në përgjithësi gjatë këtyre planeve operative janë zbuluar 38 vepra penale. Vepra penale të ndryshme në këtë katër muajor kemi 62. Krahësuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar shihet një trend në rënie të veprave penale. Sa i përket sigurisë në komunikacion ka rënie të aksidenteve në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kemi shtuar prezencën e policore në terren dhe kemi shqiptuar një numër më të madh të gjobave në trafik. Nuk është qëllimi i shqiptimit të numrit sa më të madh të kundërvajtjeve, por për të arritur te objektivi për vetëdijesimin e vozitësve dhe parandalimin e aksidenteve.

Sa i përket sigurisë në shkollë, do të inkuadrohen më vonë, pasi që kjo është paraparë si pikë e veçantë. Kjo ishte sa i përket raportit, nëse ka ndonjë pyetje jam i gatshëm të përgjigjem.

z. Nexhmi Rudari, Nënkrjetar i Komunës, falënderojmë Komandantin për raportin, ndërsa fjalën e ka përfaqësuesi i KFOR-it.

Përfaqësuesi i KFOR-it, sipas raporteve tona gjatë dy muajve të fundit gjendja e sigurisë është stabile dhe e mirë. Dua të falënderoj të gjitha institucionet relevante për çështjen e sigurisë të cilat gjatë kohës së festës së Pashkëve kanë bashkëpunuar dhe situata ka qenë e qetë dhe gjithçka në rregull. Kur flasim për gjendjen e përgjithshme të sigurisë atëherë duhet të keni parasysh edhe disa specifika, fjala është për zjarre vëniet e paligjshme në pyje dhe natyrë por gjithashtu edhe për sjelljet e pjesëmarrësve në komunikacion. Gjatë këtyre dy muajve gjendja është sensitive për dukuritë që përmenda. Unë s'jam në gjendje të jap këshilla, por kjo është pak a shumë një brengë e jona për gjendjen e sigurisë së komuniteteve dhe jetës së qytetarëve.

z. Nexhmi Rudari, Nënkrjetar i Komunës, Faleminderit për kontributin e Juaj. Ne e vlerësojmë punën që e bën KFOR-i në Kosovë në tërësi por edhe Komunën e Podujevës. Pasi që dëgjuam edhe raportin e Komandantit të Policisë, e hap diskutimin.

z. Bunjamin Hoti, përshëndes Komandantin e Policisë dhe përfaqësuesin e KFOR-it, një çështje që dua ta ngrit lidhur me çështjen e sigurisë për rininë, është fjala për përdorimin e drogave, sa kam informacione si përfaqësues i shoqërisë civile në takimet me përfaqësues të shkollave të mesme kjo dukuri është evidente dhe duke u rritur. Kam një pyetje për komandantin se a ka ndonjë strategji për luftimin e kësaj dukurie, nëse ka është përfshirë edhe sektori i rinisë që ka për qëllim sensibilizimin e opinionit. Deri më tani nuk kemi pasur informacion se është ngritë kjo dukuri tek të rinjtë e Komunës sonë. Ndoshta është formë e globalizimit që janë në trend disa çështje që janë shumë negative me mundësi të devijimeve të rinisë shpejtë dhe në përmasa të mëdha.

z. Nexhmi Rudari, Nënkrjetar i Komunës, është një shqetësim real përdorimi i substancave narkotike tek të rinjtë, por edhe çështja e zjarrvënies e cila si dukuri është duke u diskutuar disa herë. Kemi mbajtur disa herë takime me përfaqësues të fshatrave. Ajo që kemi biseduar është çështja e ambientit në përgjithësi e në veçanti mbrojtja nga prerja ilegale dhe djegia e pyjeve.

Bekim Bislimi, është vërtetë shqetësuese prezencë e substancave narkotike dhe përdorimi i tyre nga ana e të rinjve. Për këtë vitin e kaluar kemi mbajtur ligjëratë me temën përdorimi i narkotikëve dhe efektet negative. Realisht përdorimi i narkotikëve ka filluar të jetë pak më shqetësues. Vitin e kaluar kemi identifikuar disa lokacione me mbjellje të kanabisit. Në këtë drejtim kemi plan dhe jemi duke punuar, por kërkohet angazhim i të gjithë mekanizmave relevant. Realisht kjo dukuri është duke na sfiduar. Jemi duke punuar në këtë drejtim dhe do të punojmë, jemi të hapur për kontakt dhe koordinim të aktiviteteve.

z. Nexhmi Rudari, Nënkrjetar i Komunës, nga mjetet e informimit kemi parë që kohën e fundit në rajonin e Komunës së Podujevës është konfiskuar një sasi e madhe e substancave të ndryshme narkotike, mirëpo siç është proklamuar ajo ka qenë e paraparë të kalojë përtej kufirit jashtë territorit të Kosovës. Por si do që të jetë ne jemi të obliguar që të punojmë dhe të organizohemi me të gjithë mekanizmat, duke filluar prej familjeve, shkollave, institucioneve publike, në mënyrë që të arrijmë rezultate në parandalimin e kësaj dukurie. Është mirë që Drejtoria e Arsimit së bashku me Policinë të hartojnë një plan për fushatë në shkollë, me theks të veçantë në tri shkollat e mesme, për të sensibilizuar nxënësit. Nëse nuk keni diçka rreth kësaj teme kalojmë në pikën e radhës.

4. Informatë për sigurinë në shkollë

z. Nexhmi Rudari, Nënkrjetar i Komunës, fjalën e ka Drejtori i Drejtorisë së Arsimit z. Avni Maloku.

z. Avni Maloku, theksoi, në pjesën e parë të informatës kam dhënë statistikën e muajit prill 2017, dihet se kemi pasur në migrim numër të madh të nxënësve në botën e jashtme, tani kemi kthim të vazhdueshëm të tyre gjendje që rezulton me rritje të numrit të nxënësve. Aktualisht kemi 40 shkollë amë, 61 objekte shkollore me 19930 nxënës.

Mendojmë se kemi një gjendje të mirë të sigurisë nëpër shkolla përkundër se ka edhe shqetësime për arsye të disa dukurive të vazhdueshme që po na ndodhin nëpër shkolla siç janë ngacmimet e nxënësve të formave dhe llojeve të ndryshme të adoleshentëve mes veti, por njëkohësisht ka edhe grupacione të të rinjve që ka raste të krijimit të problemeve nëpër ambiente shkollore. Janë pra të pranishme disa elemente të kësaj natyre të dhunës. Kemi raste shumë të pakta të gjetjes së armëve të ftohta si thika, brisqe etj. të nxënësit. Në përgjithësi nëse i kemi parasysh këto statistika besoj se nuk e kemi një gjendje të keqe, por vlerësohet mirë. Çdoherë DA në bashkëpunim me shkolla do të jetë e përkushtuar siç ka qenë deri më sot, për ofrim të sigurisë në shkolla, mbrojtja e shëndetit, siguria dhe mirëqenia e nxënësve dhe e kuadrit në shkolla është një ndër detyrat e përgjithshme të Drejtorisë së Arsimit në Podujevë, e cila gjithashtu mbanë përgjegjësinë kryesore edhe për planifikimin, caktimin e standardeve dhe sigurimin e cilësisë së sistemit të arsimit parauniversitar. Përmirësimi i sigurisë në shkolla dhe forcimi i ndjenjës së pronësisë qytetare për zgjidhjen e problemeve të sigurisë dhe për të krijuar një mjedis më të sigurt, e një sistem më efektiv arsimor është dhe vazhdon të mbetet një ndër angazhimet e vazhdueshme të punës së Drejtorisë të Arsimit. Përkundër vlerësimit të gjendjes së mirë të sigurisë në institucionet edukativo-arsimore në Komunën e Podujevës, shqetësimet e qytetarëve megjithatë janë të pranishme, natyrisht incidentet e rralla që ndodhin në shkolla apo rreth tyre në vazhdimësi paraqesin shqetësim për nxënësit, mësimdhënësit, prindërit, por edhe për vetë institucionet. Çështjet në të cilat është e fokusuar Drejtoria e Arsimit kanë të bëjnë me:

- krijimin e infrastrukturës bashkëkohore të shkollave;
- ndriçimi lokaliteteve në afërsi të shkollave dhe oborrit të shkollave,
- eliminimi i rreziqeve që paraqiten në komunikacion, rregullimi i trotuareve,
- eliminimi i dukurive negative në shkolla (grupacionet e të rinjve, jo nxënës në afërsi të shkollave, ngacmimet e nxënësve, dhuna, si dhe prania e armëve të ftohta në shkolla),
- vetëdijesimi i nxënësve për rrezikun që paraqesin dukuritë negative (narkotikët, prostitucioni, terrorizmi, alkooli, duhani, bixhozi etj.);
- organizimi i debateve të ndryshme me nxënës,
- eliminimi i rreziqeve nga qentë endacakë, sidomos gjatë stinës së dimrit.

Për ngritjen e nivelit të sigurisë së shkollave, DA ka rregulluar rrethojat e oborrit të shkollave (24 institucione arsimore kanë rrethojë në gjendje të mirë, kurse në 16 shkolla rrethoja është e pjesshme ose e dëmtuar. Kujdes i veçantë për ndriçimin e shkollave dhe lokaliteteve rreth tyre i është kushtuar shkollave në zonën urbane, ku mbi 45% e numrit të përgjithshëm të nxënësve në Komunën e Podujevës gravitojnë në këto zona (urbane). Për të gjithë nxënësit e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët që kanë distancë më të largët se 4 km deri në shkollën më të afërt, Drejtoria e Arsimit siguron transportin. Po ashtu në afërsi të shkollave janë vendosur sinjalistika adekuate që paralajmërojnë zonat shkollore, si dhe në disa zona ku rreziku është më i lartë nga komunikacione janë rregulluar edhe stazat për këmbësor (trotuaret), e që kjo do të vazhdojë edhe më tutje.

Në institucionet edukativo-arsimore janë të formuara dhe funksionale organet qeverisëse dhe profesionale që merren me eliminimin e dukurive negative në shkolla, si dhe zhvillojnë fushata dhe aktivitete të ndryshme për vetëdijesimin e të rinjve për rrezikun që paraqesin dukuritë negative. Për nxënësit e klasave të 10,11,12 në 3 shkollat e mesme është realizuar ligjëratë kundër dhunës, terrorizmi etj me miratimin e DA-së, në bashkëpunim me organet e sigurisë.

Drejtoria Arsimit, përkushtim permanent për sigurinë në shkolla do ta ketë:

- Preventiva është shumë e nevojshme.
- Rezultatet më të mira mund të arrihen nëse shkolla nxit një atmosferë respekti, mirëkuptimi dhe tolerance dhe ku problemet dhe mosmarrëveshjet zgjidhen me metoda jo të dhunshme.
- Bashkëpunimi i ndërsjellë ndihmon shumë (me të gjitha institucionet relevante).
- Biseda me nxënësit dhe prindërit e tyre rreth sigurisë është më se e duhur.
- Sigurimin e mekanizmit përcjellës për zbatimin e plotë të kodit të mirësjelljes;
- Krijimi i kushteve për kultivim të kulturës së debatit ndërmjet mësimdhënësve dhe nxënësve;

- Të trajtojë çështjet e sigurisë si pjesë të integruara të vetë procesit mësimor duke siguruar kështu punën normale nëpër shkolla ku liria dhe siguria e nxënësve nuk do të cenohej;
- Rritja e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përkatëse: shkolla, Qendra për punë sociale, Shërbimet korrektuese, Policia, Prokuroria ,Gjykata, Prindërit,OJQ. etj.;
- Rritja e investimeve në infrastrukturën e shkollave dhe objekteve përcjellëse, si dhe instalimin e kameraeve të sigurisë në institucionet edukativo-arsimore.
- Trajnimi i vazhdueshëm i stafit të shkollës dhe prindërve, në lidhje me dhunën, format e dhunës, mënyrën e reagimit dhe masat për parandalimin e saj;
- Angazhimi i shërbimit profesional në shkolla (psikologjike, pedagogjike,dhe mjeksore)
- Zhvillimi i një programi unik të masave për parandalimin dhe zhdukjen e dhunës në mesin e nxënësve .
- Organizimi i aktiviteteve jashtë shkollore të tilla si garat sportive, shfaqje kulturore dhe artistike me qëllim të promovimit të vlerave pozitive të tilla si zhvillimi i miqësisë dhe shoqërisë të cilat mund të organizohen në nivel lokal, rajonal dhe në nivel vendi si gara individuale apo ekipore;

z. Nexhmi Rudari, Nënkrjetar i Komunës, nga informata e paraqitur u mundova ti evidentoj disa çështje që mendoj se janë të rëndësishme, u përmendën rregullimi i trotuareve dhe ndriçimi në afërsi të shkollave, është bërë një punë e mirë në shumicën e fshatrave, por ende kemi nevojë dhe probleme posaçërisht në rrugët regjionale. Do të merrja si shembull rrugën regjionale Lluzhan – Orllan mungon një pjesë e madhe e trotuarit në afërsi të Shkollës Fillore “Ilir Konushevc” në fshatin Lluge e po ashtu edhe nga fshati Kaqibeg deri te Shkolla Fillore “ Luigj Gurakuqi” në Batllavë. E dijmë se një pjesë e nxënësve të fshatit Kaqibeg vijnë në shkollën e fshatit Batllavë, ndërsa një pjesë vijnë në shkollën e fshatit LLugë, sepse fshati Kaqibeg nuk ka shkollë. Vizitat e shumta të qytetarëve në Liqenin e Batllavës, sidomos gjatë sezonit veror, ku automjetet zhvillojnë shpejtësi të madhe, reflekton edhe me aksidente të shumta ku kohën e fundit kemi pas një aksident me fatalitet. Mendoj që Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe Drejtoria e Arsimit ta kenë në vëmendje këtë rrugë sepse është rrugë me nivel të lartë të rrezikshmërisë. Po ashtu është edhe rruga për në fshatin Shajkoc edhe pse një pjesë e mirë është përfunduar. Çështje që nuk është përmendur në raport është edhe interferimi nga ana e jashtme që bëhet në shkolla. Kjo ka të bëjë siç kemi rastin për organizimin ilegal të nxënësve të shkollave të mesme për shkuarje në Brezovicë, ata nxënës shkojnë pa organizim dhe pa përkujdesje. Është mirë në këtë drejtim të bisedohet me drejtorë të shkollave por edhe me prind për të mos lejuar nxënësit në mënyrë stihike të marrin rrugë të tilla. Dhunën në shkollë nuk e përbëjnë vetëm këto elemente që ne i përmendëm. Dhunë në shkollë është edhe atëherë kur mësimdhënësi nuk e kryen punën si duhet. Nëse mësimdhënësi nuk kryen obligimet e tij, nëse mungon pa arsye, nuk i përkushtohet punës edhe kjo është dhunë, kështu që është mirë që Drejtoria e Arsimit me Drejtorë të shkollave dhe me mësimdhënësi me u kyqë si akter posaçërisht në shkollat rurale ku nuk i kemi problemet e sigurisë si në qendër. Jemi në dijeni se nga njëherë mungesat janë evidente dhe në momentin kur mësimdhënësi mungon qoftë me arsye apo pa arsye ata nxënës nuk duhet të ishin në rrugë, d.m.th. është përgjegjësi e shkollës që brenda orarit mësimor ta kenë gjithmonë nxënësit në mbikëqyrje.

z. Fadil Halimi, gjendja aktuale e sigurisë e cila po cilësohet e mirë nuk duhet anashkaluar por duhet ta mbajmë dhe ta kemi në mbikëqyrje të vazhdueshme. Deri në përfundimin e vitit kanë mbetur edhe dy muaj të cilët janë më të ndjeshëm, më kritik që situata të dalë jashtë kontrollit. Për kalimin suksesshëm të kësaj periudhe mendoj se është i nevojshëm një plan përkatës i hartuar në bashkëpunim me organizatat rinore, Drejtorinë e Arsimit, Policinë dhe subjektet tjera relevante. Në shkollat më të frekuentuara mendoj se prania e Policisë civile është më se e domosdoshme. Duke u angazhuar në këtë drejtim do të kishim mundësi për identifikimin e atyre pistave ku janë duke u përdorur substancat narkotike. Edhe për ne në shkolla mbetet obligim për të zhvilluar sa më shumë tema lidhur me këtë dukuri negative. Vlen të theksohet se Komuna jonë është prej komunave më së paku e prekur nga kjo dukuri, nga përdorimi i substancave narkotike.

z. Faik Muçiqi, kur jemi te çështja e sigurisë, sa i përket rregullimit të trotuarëve, pikërisht në disa lokacione që u përmendëm ka kontrata për ekzekutimin e punimeve për rregullimin e trotuarëve. Drejtori përmendi lokacionet dhe

rrugët për ndërtim të trotuareve. Theksoi, deri në muajin korrik pritet të përfundojmë punët. Këto tri vite i është përkushtuar vëmendje të posaçme sigurisë afër shkollave, pavarësisht kompetencës sepse shumicën e rrugëve i kemi regionale, por kemi krijuar një buxhet komunal që ndjeshëm ka ndikuar në përmirësimin e kësaj infrastrukture. Vetëm këtë vit janë mbi 14 km trotuare që do të kryhen. Është një aktivitet voluminoz por shumë ndikues për sigurinë e nxënësve. Krahas kësaj kemi bërë kërkesa që kjo të vazhdohet me përkrahje nga Ministria e Infrastrukturës dhe pritet që në fshatrat Sfeçël dhe Surkish së shpejti ta kemi një projekt.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, faleminderit për këtë informatë edhe pse unë jam në dijeni për planifikimin, por doja të diskutohet në mënyrë që edhe anëtarët e tjerë të Këshillit ta kenë këtë informatë zyrtare për punët që janë duke u kryer në drejtim të ngritjes së gjendjes së sigurisë afër shkollave. U përmend edhe ndriçimi, edhe për këtë kemi punuar bukur mirë, sepse ndriçimi përmirëson gjendjen e përgjithshme të sigurisë.

z. Bekim Bislimi, në kërkesë të Kuvendit të Komunës kam qenë prezentë në takim dhe pikërisht u diskutuan, siguria në sholla dhe siguria në komunikacion. Sa i përket angazhimit tonë në raport me sigurinë në shkolla ne kemi mbajtur ligjëratat të ndryshme, kemi prezencë permanente të zyrtarëve policor në rroba civile. Në raport me të gjitha qendrat tjera ne qëndrojmë mirë. Nuk duhet të harrojmë incidentin që ndodhi në muajin e kaluar, lëndimin e një nxënësi, rasti është në procedurë hetimore dhe besoj se do të ketë rezultat konkret në këtë çështje. Përveç mjeteve të forta kemi dy raste ku janë konfiskuar armë zjarri. Nuk duhet të ndihen përgjegjës vetëm organet e shkollës dhe Policia kushtimisht po them. Ta ndajmë barrën e përgjegjësisë, secili të jetë përgjegjës për atë që i takon. Sa i përket sigurisë në komunikacion, gjithashtu e dimë që është sfidë, dua të ju transmetoj një çështje, prej vitit të kaluar kur ka hyrë në fuqi Ligji për komunikacionin rrugor, prej muajit shtator kur ka filluar të implementohet i kemi afër 2000 kundërvajtje të shqiptuara në komunikacionin të cilat momentalisht qëndrojnë në sirtarë të Stacionit Policor dhe materializimi i tyre ka për të qenë problem për shkak të ndërrimit të Ligjit të komunikacionit. Ne e kemi ngritur këtë çështje në Nivelin qendror por edhe Nivelin qendror e ka ngritur në mekanizmat tjerë për të punuar diçka në këtë drejtim. Mendoj se do të kemi sfidë të jashtëzakonshme në komunikacion, siguria në komunikacion por as vetëdijesimi nuk ka për të qenë në shkallën e duhur. Shpresoj se diçka do të ndërmarrin në këtë drejtim.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, mendoj se sfidë e veçantë këtë vit paraqet edhe zgjerimi i rrugës Podujevë- Prishtinë. Ne e presim me padurim si qytetarë të Komunës së Podujevës, megjithatë kjo krijon mjaft shqetësime dhe ankesa nga banorët për shkak të pluhurit. Me ardhjen e bashkatdhetarëve tanë nga muaji korrik ne duhet shikuar bashkë me Policinë për shenjëzim të ri të rrugëve në mënyrë që bashkatdhetarët që vijnë nga kufiri i Merdarit me i orientuar në rrugë dytësore siç është rruga për në fshatrat Shajkoc, Sfeçël për t'i ikur rrugës ku është duke u punuar në distancë prej 3-4 km. Pra që tani duhet njoftuar me kohë qoftë me vendosjen e shenjave orientuese apo përmes ndonjë fletushke, të cilat do tu jepeshin vozitësve në kufi nga Policia kufitare. Nëse nuk ka dikush tjetër diçka rreth kësaj teme, kalojmë në pikën e radhës.

5. Masat parandaluese kundër djegieve të pyjeve (Koordinimi i aktiviteteve në mes DBPZHR, DSHPMSh, SHZSH, Policisë, Agjencionit Pyjor, Agjencionit për Menaxhimin Emergjent)

-Informatë nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

-Informatë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, fillimisht fjalën e ka Drejtori z. Faik Muçiqi.

z. Faik Muçiqi, theksoi, raportin e gjendjes së deritanishme e ka përgatitur Shefi i Shërbimit të Zjarrfikësve, i cili është prezent në këtë takim dhe nisur nga kompetenca mund të përgjigjet nëse ka ndonjë pyetje konkrete operative.

Nga data 01.01.2017- 21.04.2017 Shërbimi i Zjarrfikësve ka intervenuar në 150 raste të ndryshme që krahasuar me vitin e kaluar që ka qenë 118 raste rezulton rreth 25 % ka ngritje të numrit të intervenimeve.

Nëse merret struktura e zjarreve në këtë periudhë ajo është diku 93 raste të ndryshme të zjarreve në pyje, fusha etj. Sipërfaqet e dëmtuara nga zjarri në pyje janë 93.78 hektar, ndërsa në fusha janë 26.40 hektar. Koordinimi i aktiviteteve në mes Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Agjencionit të Pyjeve dhe i Policisë është i domosdoshëm në këtë fazë, posaçërisht në atë verore. Dukuria e djegies së qëllimshme po vazhdon, andaj duhet më shumë preventivë me qëllim që kjo mos të shkojë në ngritje e sipër. Në të gjitha shkaqet është vlerësuar se është faktori njeri dhe në të gjitha rastet ndodhë që të shkaktohen qoftë nga pakujdesia apo qëllimisht, mirëpo nuk e shërbimit tonë të merremi me shkaqet dhe personat. Shpresojmë që edhe

policia këtë vit do t'i identifikoj dhe do të marr masa penalizuese ndaj gjithë atyre keqbërësve dhe ndezësve të zjarreve. Aktivitetet kanë të bëjnë edhe me sensibilizimin që duhet të punojmë në 4-5 segmente të sigurisë që i kemi bërë dhe në fletushka dhe udhëzues me qëllim të parandalimit të zjarreve dhe vetëdijesimit të bujqve për pasojat nga djegiet. Është bërë një traditë e keqe se më mirë është djegia e hamulloreve por edhe bujqit janë duke e kuptuar se kjo është e dëmshme.

Agjencioni i Pyjeve të Kosovës përveç subjekteve të tjera duhet të jetë më aktiv sepse duhet ndihmuar edhe me ekipe ndihmëse për shuarje të zjarreve. Kemi theksuar edhe më parë se shuarja e zjarrit në pyje është e ndjeshëm sepse nuk mund të hyhet me mekanizëm të madh por duhet të hyhet me numër më të madh të njerëzve. E përsëris se shkaktarët e djegieve të pyjeve duhet të dënohen dhe ato duhet të publikohen, përndryshe kryerësit e këtyre veprave e ndiejnë vetën të liruar. Shërbimi i zjarrfikësve do të angazhojë edhe e tre punëtorëve sezonal, megjithatë është mungesë e stafit edhe në Shërbimin e Zjarrfikësve, të zyrtarëve policor, rojtarëve posaçërisht edhe e APK-se.

z. Avni Fetahu, bazuar në raportet e rojeve të pyjeve dhe evidencës tone për periudhën janar-prill 2017 , përkatësisht deri më 11.04.2017, kemi pasur gjithsej 22 raste të shfaqjes së zjarreve të cilat kanë përfshirë një sipërfaqe prej 53,90 ha, krahasuar me vitin e kaluar që kanë qenë 77.05 ha. Prej tyre 13 raste kanë qenë në pronë shtetërore, ndërsa 9 raste në pyje private. Rastet e lartcekura janë lajmëruar si nga rojet e pyjeve ashtu edhe nga qytetarët të cilët kanë marrë pjesë së bashku me shërbimin e zjarrfikësve në shuarjen e tyre. Koordinimi në mes Policisë së Kosovës dhe zjarrfikësve ka qenë në nivel. Informatës i kemi bashkëngjitur edhe një formë tabelore. Ne si Drejtori këtë vit kemi bërë një mobilizim pak më ndryshe të rojeve të pyjeve, i kemi kushtuar më shumë vëmendje kësaj çështjeje, në mënyrë që rastet të lajmërohen me kohë dhe të jenë më afër zjarreve që janë identifikuar si vende me potencial të rrezikut. Pra janë disa vende që vazhdimisht janë përsëritë zjarret dhe i kemi orientuar aty. Me dt. 07.04.2017 kemi mbajtur një takim sensibilizues me qytetarë, me kryetarë të fshatrave, me media, prezentë kanë qenë edhe institucionet lokale dhe ato qendrore, pjesëtarë të Stacionit policor por edhe të Policisë Kufitare. Qëllimi kryesor i këtij takimi ka qenë ruajtja e ambientit në përgjithësi. Më datën 11.04. 2017 kam qenë prezentë në fshatin Metehi, lagja Shala, më ka bërë përshtypje se përveç intervenimit të zjarrfikësve ka qenë edhe një ekip i Stacionit Policor dhe kjo reflekton dukshëm në këtë çështje që është problematike.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, vërtetë kjo gjendje është duke na përcjellur një kohë të gjatë dhe po dëmton ekonomikisht shtetin e Kosovës dhe pronarët privat. Është mirë nga ky takim t'i bëjmë një kërkesë Agjencionit të Pyjeve të Kosovës që të fillojnë të mendojnë seriozisht në përdorimin e teknologjisë bashkëkohore të ruajtjes së pyjeve e posaçërisht nga zjarr vënia. Agjencioni ka vendos në disa pjesë të pyjeve disa kamera por si duket ato kamera nuk e kanë dhënë efektin e duhur. Agjencioni duhet të mendojë pse jo edhe për përdorimin e dronëve në nivel vendi për incizimin dhe mbrojtjen e pyjeve. Kjo tashmë nuk është një teknologji e pa përballueshme për ne. Nëse keni ndonjë pyetje e kemi prezent edhe shefin e zjarrfikësve z. Milaim Ajvazi.

z. Milaim Ajvazi, unë vetëm desha të ju njoftoj për investimet në Shërbimin e Zjarrfikësve. Gjatë dy viteve të fundit Qeveria është duke investuar 600000 € në Komunën tonë, në shërbimin e zjarrfikësve kështu që sa i përket aspektit teknik jemi mjaft të përgatitur, pothuajse jemi numër një në Kosovë me kushte dhe me automjete të reja, ndërsa sa i përket kapaciteteve njerzore jemi mjaft mbrapa, kemi nevojë për 100% të rritjes së stafit. Kërkoj nga ky Këshill këtë çështje ta ngritë si shqetësim, për arsye se nuk ofrojmë asgjë tjetër përveç siguri për qytetarët.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, e kemi problemin e kapaciteteve njerzore sepse MAP nuk lejon rritjen e numrit të punëtorëve në Komunë por duhet bërë kërkesë. Komuna e Podujevës është Komuna me territor më të madhin në Kosovë, ndërsa ka numër të vogël të zjarrfikësve. Do të duhej ti kemi së paku edhe tri qendra të zjarrfikësve, në rajonet e fshatrave Kërpimeh, Lluzhan dhe Orllan, por kemi vetëm një qendër të zjarrfikësve që është e pamundur ti përgjigjet dhe të mbulojë në kohë tërë territorin e Komunës.

Përfaqësuesi i KFOR-it, më vjen mirë që në këtë takim u diskutuan shumë çështje me rëndësi për sigurinë në përgjithësi. U ngritë çështja e punimeve në rrugën Podujevë- Prishtinë, pyetja është a ka ndonjë plan për devijimin e rrugës dhe vendosjen e shenjave të komunikacionit për orientimin e vozitësve që vijnë nga drejtimi i Merdarit. Sa i përket zjarreve në pyje dhe fusha mendoj se është mirë të organizohen trajnime për ngritjen e nivelit të ndërgjegjes së atyre njerëzve.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, këtë çështje e diskutuam, ne e ngritëm si shqetësim dhe për të shqyrtuar mundësinë për vendosjen e shenjave të reja të komunikacionit dhe për të publikuar fletushka për vozitësit. Ndërsa

sa i përket zjarreve të pyjeve ne mendojmë se zjarr vënia e qëllimshme nuk bëhet për arsye tjera përveç se për mbulimin e akteve të tyre kriminale.

6.Të ndryshme

Nuk pat diskutime

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, Nënkyetari përfundoi mbledhjen pasi nuk pat çështje tjera për shqyrtim, ndërsa të pranishmit i falënderoi për pjesëmarrje dhe kontribut.

Mbledhja përfundoi në orën 11.15

Procesverbalin e mbajti

Sabedin Namani

Nr. 02-060/04-0036630/17

Podujevë,

27 prill 2017

Kryetari i Komunës

Agim Veliu